



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së dytë të Komitetit për Politikë dhe Financa të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 16.2.2012, e cila filloi në orën 15:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Sami Hamiti, Mustafë Krasniqi, Tefik Mehmeti, Hazir Borovci, Aziz Pacolli, Milazim Vitia, Engin Beyoglu dhe Shefqet Sylejmani.

Mungoi: Shemsi Veseli (me leje).

Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive të Komunës dhe përfaqësuesit e OSBE - së.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Sami Hamiti, kryesues.

Njëzëri u miratua ky

REND DITE :

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë;**
- 2. Raporti i punës për vitin 2011;**
- 3. Propozimvendimi për plotësimin e Vendimit për emërtimin dhe zyrtarizimin e lagjeve, shesheve dhe rrugëve të komunës së Prishtinës;**
- 4. Propozimvendimi për bartjen e mjeteve nga viti 2011 në vitin 2012;**
- 5. Propozimvendimi për ndryshimin e Rregullores për transparencë;**
- 6. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të xhamisë në Prishtinë;**
- 7. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Tregut të kombinuar;**
- 8. Informatë për suksesin e nxënësve në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2011 - 2012;**
- 9. Të ndryshme.**

Faqe 1 nga 4

Pika e parë

Njësori u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së dytë.

Pika e dytë

Kryesuesi tha se është një raport i strukturuar shumë mirë, që tregon punën reale, mjaft i avancuar, ku janë paraqitur sukseset dhe sfidat. Shpenzimi i buxhetit në normën prej 80% është si shpërndarje shumë e mirë, ku 52 % e mjeteve të shpenzuara janë për investime kapitale. Arkëtimi i të hyrave, në nivel prej 94%, është shumë i mirë, por ndarja e granteve nga Qeveria është diskriminuese.

Aziz Pacolli shtoi se duhet të thuhet diç edhe për projektet e planifikuara, të cilat nuk janë realizuar, të mos jetë ky raport vetëm me lëvdata, por të ketë edhe kritika. Drejtoritë do të duhet të ishin vetëkritike dhe të përmendnin edhe sfidat.

Kryesuesi shtoi se ka edhe probleme dhe ato janë cekur në raport.

Tefik Mehmeti theksoi se është raport shumë i përgjithësuar, real dhe me informata të sakta. Sa i përket disa ngecjeve, është ngarkesë nëse lëshohemi në disa paqartësi, të cilat duhet të kryhen, siç është pronësia etj. Nëse krahasohemi me komuna të tjera, asnjë komunë, pavarësisht se si kanë dalë shifrat e regjistrimit të popullsisë, ajo e Prishtinës ka popullatën më të madhe, andaj duhet bërë presion që të ndërtohen më shumë shkolla dhe kjo nuk mund të bëhet vetëm me të hyra vetanake, por duhet bërë presion te Qeveria për një gjë të tillë. Numri i të punësuarve në administratë nuk është në rregull, sepse Komuna e Prishtinës duhet të ketë benificione në krahasim me komunat e tjera. Të gjitha grantet e tjera janë të përshkruara si duhet.

U konstatua se njëzëri u përkrah Raporti i punës për vitin 20011 dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e tretë

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës arsyetimin e paraqiti **Agim Salihu**.

Engin Bejogllu tha se nuk e ka nënshkruar listën përfundimtare, për shkak se nuk është marrë parasysh propozimi i komuniteteve për përfshirjen e pesë emrave, për të cilat Komisioni nuk ka pasur vërejtje, andaj kërkoi që ata të përfshihen në këtë listë.

Aziz Pacolli propozoi që në të ardhmen rrugët të shenjëzohen me numra dhe shtoi se nuk është për atë që rrugët me emrat e propozuara nga Engin Bejogllu të jenë në periferi, apo aty ku nuk përket me emrin e vendit ku propozohet.

Kryesuesi shtoi se lidhur me emrat e propozuara nga Engin Bejogllu, duhet të shikohet dhe të gjendet një zgjidhje me Komisionin për emërtimin e lagjeve, shesheve dhe rrugëve.

Tefik Mehmeti shprehu besim në Komision, sidomos në kryetarin e tij, i cili është në nivel lidhur me këto çështje. Përkrahu propozimin e z. Aziz Pacolli, por duke mos i ndryshuar rrugët e vjetra, si rr. "Vushtrria" etj. ndërsa për rrugët e reja duhet të shikohet. Është paraparë edhe Zona Ekonomikënë, në kuadër të së cilës do të ketë shumë rrugë, por sa është e arsyeshme futja edhe e 4-5 rrugëve në atë zonë.

Kryesuesi paraqiti sqarime lidhur me emërtimet e propozuara.

Milazim Vitia theksoi se sa i përket këtij Komisioni, kryesisht është marrë me emërtimin e rrugëve dhe shesheve të reja dhe puna e tij është në vazhdimësi. Kemi pasur disa probleme me

Shoqatat e dala nga lufta, pasi që nuk janë përfshirë emrat e të gjithë dëshmorëve të propozuar, por shpresojmë se kjo do të realizohet në të ardhmen.

U konstatua se u përkrah Propozimvendimi për plotësimin e Vendimit për emërtimin dhe zyrtarizmin e lagjeve, shesheve dhe rrugëve të komunës së Prishtinës dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e katërt

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës informoi **Xhelil Bekteshi**.

Tefik Mehmeti tha se çdo komunë që ka projekte të mëdha, do të ketë bartje të mjeteve dhe bartja e propozuar nuk do të ndikojë në buxhetin e këtij viti. Është shumë mirë që këto mjete janë të dedikuara dhe do të shkojnë aty ku duhet, gjë të cilën e lejon edhe ligji.

Aziz Pacolli tha se në përgjithësi materiali i propozuar është në rregull, me disa gabime të vogla, si në vend të 64 duhet të jenë 94 centë.

U konstatua njëzëri se u përkrah Propozimvendimi për bartjen e mjeteve nga viti 2011 në vitin 2012 dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e pestë

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës informoi **Agim Salihu**.

Kryesuesi përveç tjerash, informoi edhe për rrjedhat e mbledhjeve dhe pjesëmarrjen e mediave në ato mbledhje.

Aziz Pacolli pyeti se çka nënkupton fjala “opinion” në nenin 5, pika 5.1.

Kryesuesi dhe Agim Salihu u përgjigjën në pyetjet e parashtruara.

U konstatua se u përkrah njëzëri Propozimvendimi për ndryshimin e Rregullores për transparencë dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e gjashtë

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës informoi **kryesuesi**.

Aziz Pacolli theksoi se duhet treguar kujdes, në mënyrë që të mos priset Plani rregullues i qytetit .

Behxhet Musliu shtoi se vendimi ka të bëjë vetëm me caktimin e lokacionit, ndërsa marrëdhëniet tjera rregullohen me kontratë të veçantë.

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të xhamisë në Prishtinë dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e shtatë

Agim Gashi paraqiti arsyetimin për këtë propozim.

Behxhet Musliu paraqiti sqarime shtesë.

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Tregut të kombinuar dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e tetë

Përkritazi me këtë pikë të rendit të ditës të pranishmit i informoi **Halim Halimi**.

Aziz Pacolli tha se informata është e kompletuar ashtu si kërkohet, por nuk ndërmerren masa ndaj atyre mësimdhënësve, të cilët nuk punojnë sa dhe si duhet dhe me vite të tëra lejohen që të veprojnë në këtë mënyrë.

Ai gjithashtu pyeti se a është realizuar planprogrami vjetor, duke thënë se është dashur që edhe nga ana e shkollës të jetë një komision monitorues, i cili do t'i bënte vlerësimet e duhura.

Halim Halimi dhe **Agim Gashi** paraqitën disa sqarime shtesë.

U konstatua se u përkrah Informata për suksesin e nxënësve në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2011 - 2012 dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e nëntë

Të ndryshme

Milazim Vitia tha se është punuar rreth pastrimit të borës, por ka shumë vende që janë të bllokuara, si lagjet “Vrajovc” dhe “Canaj”, andaj kërkoi që t'u dilet në ndihmë atyre njerëzve.

Agim Gashi premtoi se së shpejti ajo pjesë do të pastrohet nga bora, pasi që ekipet kanë dalë në terren.

Mbledhja mbaroi punën në orën 16:30.

PROCESMBAJTËSJA

Alije Gusia

KRYESUESI I KOMITETIT

Sami Hamiti, ecc. i dipl.